

**SHENIME PER
PASQYRAT FINANCIARE
PER VITINE MBYLLUR ME 31 Dhjetor 2024**

I. Informacione te pergjithshme

Shoqata " FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF eshte krijuar si nje organizate jo qeveritare me statusin e organizates jo fitimprurese, regjistruar me Vendim te Gjykates se Shkalles Pare Tirane date 22.01.2021.

Administrimi i Shoqates" FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF behet nepermjet organeve te veta, te krijuara nga anetaret e saj dhe te bazuara ne rregullat statutore.

II. Politikat kontabel

Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne perputhje me ligjin 9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar. Ndertimi i pasqyrave financiare behet sipas Standardeve Kombetare Kontabel per OJF (SKKper OJF).

Baza e matjes e perdorur per pergatitjen e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e parimit te kostos historike. Pasqyrat financiare pergatiten ne monedhen vendase, " leku" shqiptar.

III. Parimet kontabile me te genesishme te perdorura per pergatitjen e ketvye pasqyrave financiare.

Vijimesia

Ne pergatitjen e pasqyrave financiare jane marre ne konsiderate parashikimet dhe buxhetet si dhe burimet e financimit ne perputhje me aktivitetin e Organizates te percaktuara ne Statutin e saj.

Qendrueshmeria e paraqitjes

Paraqitja si dhe klasifikimi i zerave ne pasqyrat financiare eshte bere ne perputhje me Pasqyrat Financiare per OJF te publikuara nga KKK. Pasqyrat e pergatitura jane : Pasqyra e Pozicionit Financiar, Pasqyra e Aktiviteteve ose e Performances bazuar ne shpenzimet e kryera sipas funksionit dhe Pasqyra e Flukseve te Mjeteve Monetare.

Monedhat e huaja

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne leke me kursin valuator te kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Per likujditetet ne monedha te huaja qe ekzistojne ne mbyllje te ushtrimit konvertohen me kursin e kembimit te fundvitit dhe diferencat kalojne

ne rezultatin e ushtrimit, si fitime apo humbje nga kembimi. Kurset kryesore te kembimin ne daten e bilancit kane qene 1 USD = 94.26 ALL dhe 1 EUR =98.15 ALL.



Kerkesa te arketueshme dhe detyrime te pagueshme

Kerkesat e arketueshme dhe detyrimet per tu paguar ne mbyllje te ushtrimit jane paraqitur sipas vleres se regjistruar ne daten e lindjes se tyre (me vleren e tyre nominale).

Aktivitet Afatgjata Materiale

Aktivitet afatgjata materiale perbehen kryesisht nga pajisje zyre dhe pajisje informatike. Ato paraqiten ne pasqyren e Pozicionit Financiar te pasqyrave financiare me vleren kontabile neto te tyre. Per to llogaritet amortizim mbi bazen e vleres se mbetur, vlera vjetore e te cilit kalon ne pasqyren e rezultatit.

Aktivitet Neto

Teprica / deficitit midis te ardhurave dhe shpenzimeve qe krijohen ne ushtrimin kontabel pasqyrohen si ndryshim ne Aktivitet Neto te OJF.

IV. Aneke te pasqyrave financiare**Aktive monetare (Likujditete ne Arke dhe Banke)**

Gjendjen e mjeteve monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute me 31 dhjetor 2024 eshte si me poshte :

<i>Banka Raiffeisen ne Lekë 1</i>	5,616,927
<i>Banka Raiffeisen ne Lekë 2</i>	256,466
<i>Banka Raiffeisen ne Lekë 3</i>	-501
<i>Banka Raiffeisen ne Euro</i>	1,590

Llogarite e likujditeteve ne valute jane pasqyruar te konvertuara ne leke me kursin e dates 31.12.2024 te shpallur nga Banka e Shqiperise.

Kontribute të arkëtueshme

Kjo llogari eshte ne Shumen 4, 936 Leke dhe perfaqeson parapagime per pagat e punonjesve (E Z.).

Detyrime Te pagueshme Shteti

Gjendjet Detyrimeve si te pagueshme per shtetin ne fund te vitit ushtrimor jane paraqitur me vleren nominale te shumes per tu paguar.

<i>Detyrime per Sigurime shoqerore e shëndetsore</i>	96,275
<i>Tatim mbi te ardhurat ne burim</i>	0

Detyrimi per sigurimet shoqerore perfaqeson detyrimin e punonjesve te OJF per sigurimet shoqerore te OJF per periudhen dhjetor 2024 te cilat jane likujduar brenda muajit janar 2025.

Detyrimi per tatimin mbi te ardhurat ne burim, perfaqeson detyrimin e llogaritur per Perfituesit e fondeve te Administrimit kolektiv te Te drejtave te Autorit te Prodhuesit e Fonogramit "Individ", sipas legjislacionit perkates ne fuqi.

Detyrime Te pagueshme furnitore

Gjendja e Detyrimeve si te pagueshme per Furnitoret eshte ne Shumen 297,404 Leke. Ne kontabilitetin e OJF keto detyrime evidentohen analitikisht.

Detyrime te pagueshme Personeli

Ne pasqyrat financiare viti 2024 detyrimet qe perfaqesohen nga pagat e papaguar te personelit jane zero.

Detyrime te tjera te pagueshme

Kjo llogari ne pasqyrat financiare te Shoqates "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF eshte ne Shumen 5,340,070 Leke dhe perfaqeson shperndarjen e Fondeve per Subjektet private dhe Individet qe do te perfitojne nga Administrimi Kolektiv i Te drejtave te Autorit per Prodhuesit e Fonogramit per vitin 2024.

Premtime te kushtezuara per tu dhene

Kjo llogari qe perfaqeson te ardhura per Subjekte apo Individe te Administrimit Kolektiv mbajtes se te drejtave te phonogramit, te cilet jane ne proces evidentimi me Agjencite si motra, dhe do te shperndahen pasi te perfundoje ky proces.Kjo llogari eshte ne Shumen 145,669 Leke.

Aktive Neto

Gjate ketij ushtrimi kontabel Aktivet Neto te Shoqates "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF jane pakesuar me diferencen e te ardhurave (fondeve te perfituara) dhe shpenzimeve te ushtrimit qe mbyllet me 31.12.2024.

Te ardhurat dhe shpenzimet

Shoqata "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF harton dhe zbaton buxhetin e saj per realizimin e funksioneve dhe objektive qe rrjedhin nga statuti. Te ardhurat dhe shpenzimet e realizuara, jane si vijon :

Te ardhurat

<i>Te ardhurat</i>	8,398,695
<i>Te ardhura nga kontribute vullnetare e te tjera</i>	0
<i>Te ardhura nga Agjenci te Financimit SUADA viti 2024</i>	8,398,695

Shoqata "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF bazuar ne legjislacionin per perfitimin dhe shperndarjen e fondeve te Administrimit kolektiv te Te drejtave te Autorit per Prodhuesit e Fonogramit ka perfituar deri me 31 dhjetor 2024 (periudha janar – nentor 2024) nga Agjencia "SUADA" Pjese Takuese per te Drejten e Autorit per vitin 2024 Shumen 8,398,695 Leke.



Kjo shume do te perlogariten per tu shperndare, pasi te arketohet edhe te ardhurat e muajit dhjetor 2024, si Pjese Takuese per te Drejten e Autorit per vitin 2024, duke marre ne konsiderate edhe shpenzimet e administrimit sipas legjislacionit ne fuqi.

Shpenzimet sipas Aktiviteteve kryesore

Shoqata "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF ne vitin 2024 ka hartuar strategjine e aktivitetit kryesor te saj, ne perputhje edhe me te ardhurat e pritshme dhe te realizuara ne vitin 2024. Per periudhen nga krijimi si OJF deri 31 dhjetor 2024, fondet qe jane llogaritur per tu shperndare jane ne Shumen totale 5,340,070 Leke. Kesaj shume do ti shtohen te ardhurat per muajin dhjetor 2024 qe do te arketohen pas rakordimit me SUADA per vitin 2024.

Shpenzimet Administrative

Shpenzimet Administrative dhe shpenzime te tjera te pergjithshme sipas grupeve kryesore paraqiten si me poshte:

Shpenz kanceleri	5,000
Shpenz Materiale publikimi	50,012
Shpenz komision bankar	45,644
Sherb nga te tretet Fiskalizim, Auditim	126,000
Sherbime nga te tretet Kontabilitet	390,000
Sherbime Monitorimi	31,799
Shpenz Mbajtje Database	111,181
Shpenz nga te trete noter	58,760
Shpenz nga te trete perkthime	18,000
Shpenz nga te trete Kompozim	47,000
Shpenz Pritjeje	10,000
Shpenz Te tjera taxa	362,076
Paga personeli	1,484,783
Sigurime shoqerore	318,370

Keto shpenzime jane pasqyruar ne pakesim te Aktiveve Neto te Shoqates "FABER COLLECTIVE PHONOGRAM "OJF

Anxhela Daj
Drejtore Ekzekutive

Tirane, me 03 Mars 2025

